

<b>Të dhënat bazike të lëndës</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti Filozofik - Departamenti i Historisë
Titulli i lëndës:	Histori moderne shqiptare I
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i tretë (III), semestri V
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Sipas orarit të paraparë në fillim të semestrit
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Bujar Dugolli
Detajet kontaktuese:	bujar.dugolli@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Kjo lëndë ofron njohuri themelore mbi ngjarjet, fenomenet dhe proceset historike që shënuan fillimet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare apo historinë moderne shqiptare 1830-1878.</p> <p>Vëmendja do të përqendrohet kryesisht në fenomenet nga fusha e zhvillimit të mendimit politik, shoqëror, kulturo-arsimor, religjioni, rregullimit politik, diplomacia, ekonomia etj. Shek. XIX për popullin shqiptar, ashtu si edhe për popujt e tjerë të Ballkanit, shënoi një epokë të re, atë të Rilindjes.</p> <p>Kjo periudhë ka hyrë në historinë moderne të vendeve të Ballkanit si shekulli i lëvizjeve dhe i revolucioneve kombëtare, që ndoqën njëri-tjetrin dhe që çuan në çlirimin e shumicës së popujve të këtij gadishulli nga sundimi i Perandorisë Osmane dhe në formimin e shteteve të tyre pavarura.</p> <p>Këto lëvizje u zhvilluan në kushtet e dekadencës së Perandorisë Osmane, të shthurjes së marrëdhënieve të vjetra feudale dhe të lindjes së ekonomisë së tregut, të zgjimit të mëtejshëm të ndërgjegjes kombëtare të popujve të këtij gadishulli dhe të zgjerimit të ndërhyrjeve të Fuqive të Mëdha në këtë perandori, por edhe tek disa vende të Ballkanit.</p> <p>Historia moderne shqiptare përbën një lëvizje të gjithanshme kombëtare, me një përmbajtje të re ideologjike, politike, kulturore, ekonomiko-shoqërore dhe organizative.</p> <p>Ajo Lëvizje kombëtare e shqiptarëve synonte të zgjidhte detyrat që i takonin çështjes kombëtare, të çlironte vendin nga sundimet e huaj osmanë, të bashkonte trojet shqiptare në një shtet të vetëm e të pavarur, t'i ndalte ambicet e fqinjave ballkanikë</p>

	<p>ndaj pushtimit të tokave shqiptare, t'u hapte rrugën zhvillimit e përparimit ekonomiko-shoqëror, politik e kulturor.</p> <p>Në fokus do të jenë: reformat e Perandorisë Osmane, të njohura me emrin tanzimati, si dhe reflektimi i tyre te shqiptarët; përmbajtja dhe tiparet e Rilindjes; zhvillimi i nacionalizmit shqiptar dhe programi i tij politik; vendi dhe roli i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në historinë moderne shqiptare dhe përpjekjet e shqiptarëve për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë, para dhe pas vendimeve të Kongresit të Berlinit; shqiptarët në perspektivën e Evropës Perëndimore; marrëdhëniet e shqiptarëve me Perandorinë Osmane dhe me fqinjët ballkanike etj.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve, do të synohet që studentët, jo vetëm të marrin informacionin e duhur, por edhe të nxiten për diskutime dhe analiza të pavarura rreth tematikës që do të shtjellohet gjatë procesit mësimor.</p> <p>Përmes kësaj metodologjie studentet do arrijnë t'i kuptojnë zhvillimet politike dhe kulturore në kohën e konsolidimit të kombit shqiptar, vështirësitë që i kishte Lëvizja Kombëtare Shqiptare në raport me Perandorinë Osmane, por edhe përgjigjen që i dha Lëvizja Kombëtare Shqiptare aspiratave pushtuese të disa popujve të Ballkanit.</p> <p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do mund të njohin më mirë historinë kombëtare, në periudhat e lartpërmendura, do të aftësohen për të bërë analiza dhe kritika, me qëllim të vlerësimeve sa më të drejta historike, do njohin më mirë politikën, por edhe diplomacinë e Fuqive të Mëdha dhe popujve fqinjë të shqiptarëve.</p> <p>Ky është qëllimi, por edhe objektivi i kësaj lënde për edukimin edhe avancimin e arsimit të lartë në Kosovë.</p>
<p>Rezultatet e pritura të studentit:</p>	<p><i>Nga kjo lëndë studentët:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Do të kuptojnë dhe do të mësojnë ta interpretojnë drejt fenomenin e ngritjes së <i>çështjes shqiptare</i> në Ballkan, në raport me rrethanat e kohës.</li> <li>• Do ta kuptojnë ndërlidhshmërinë dhe komparacionin e fenomeneve ekonomike,</li> </ul>

	<p>sociale, kulturore, politike dhe religjioze të shqiptarët.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Do të jenë në gjendje të diskutojnë mbi konceptet themelore të shkencës moderne, duke i marrë për bazë veprat monumentale të rilindësve tanë.</li> <li>• Do të jenë në gjendje t'i kuptojnë dhe t'i diskutojnë fenomenet e ndryshme shoqërore dhe qëndrimin e klasës politike e intelektuale të shqiptarëve të asaj kohe.</li> <li>• Do të kuptojnë për raportet e shqiptarëve në Perandorinë Osmane dhe fqinjët ballkanikë si: serbët, greket, bullgarët, malazezët etj.</li> <li>• Do të mund të analizojnë dhe të krahasojnë raportet e diplomacisë ndërkombëtare, sa i përket çështjes shqiptare në Ballkan, para dhe pas Kongresit të Berlinit (1878) etj.</li> </ul>
--	---

**Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15 javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15 javë	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.30	10 javë	3
Ushtrime në terren	-	-	-
Kolokviume, seminare	2	4 javë	8
Detyra të shtëpisë	1	1 javë	1
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15 ditë	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15 ditë	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1 javë	2
Projektet, prezantimet etj.	1	1 ditë	1
<b>Totali</b>			<b>150:25= 6 ECTS</b>

Metodologjia e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjërata (<i>forma e kombinuar – interaktive</i>)</li> <li>- Ushtrime (<i>hartimi i punimeve shkencore, diskutimi i tyre në grupe dhe komunikimi interaktiv, lidhur me punimet e studentëve</i>)</li> <li>- Komunikimi përmes internetit dhe konsultimet e parapara në ditët përkatëse</li> </ul>
------------------------------	---

	- Verifikim i dijes përmes testimiit dhe provimeve me gojë dhe me shkrim.
Metodat e vlerësimit:	- Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata ----- 10 % - Pjesëmarrja aktive në diskutime gjatë ligjëratave ----- 15 % - Angazhimi ne projekte hulumtuese, punime seminarike më prezantime ----- 20 % - Provimi final - me gojë dhe me shkrim ---- 55 % Totali -----100 %
<b>Literatura</b>	
Literatura bazë:	- Akademia e Shkencave e Shqipërisë. <i>Historia e popullit shqiptar. Vellimi II. Rilindja Kombëtare. Vitet 30- të shek. XIX- 1912.</i> Tiranë: Toena 2002 - <i>Akte të Rilindjes Kombëtare.</i> Tiranë: 1978 - Frashëri, Sami. <i>Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet.</i> Bukuresht: 1899 dhe ribotim, Prishtinë: 1978 - Brestovci, Sadullah. <i>Marrëdhëniet shqiptaro-serbo-malazeze 1830-1878.</i> Prishtinë: 1983 - Dugolli, Bujar. <i>Marrëdhëniet shqiptaro- Serbe 1878-1912.</i> Prishtinë: 2011 - Rizaj, Skënder. <i>Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze, 1878-1881.</i> Prishtinë: 1978 - Rizaj, S. Gazmend. <i>Shqipëria e Sipërme,</i> Instituti Albanologjik. Prishtinë: 2011 - Rexha, Ilijaz. <i>Lidhja e Prizrenit në dokumentet osmane, 1878-1881.</i> Prishtinë: 1978 - Rrahimi, Shukri. <i>Vilajeti i Kosovës,</i> Prishtinë: 1969 - Skendi, Stavro. <i>Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912.</i> Tiranë: 2000 - Shehu, Bedrush. <i>Çështja shqiptare gjatë viteve tridhjetë të shekullit XIX.</i> Prishtinë: 1980 - Shpuza, Gazmend. <i>Gjurmime në epokën e Rilindjes Kombëtare.</i> Tiranë: 1980 - Uka, Sabit. <i>Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877-1878, I.</i> Prishtinë: 1994 - Frashëri, Kristo. <i>Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881.</i> Tiranë: 1997 - Qosja, Rexhep. <i>Çështja shqiptare, historia dhe politika,</i> Prishtinë: 1994

Literatura shtesë:

a. Literatura e autorëve të huaj:

- Malkolm, Noel. *Kosova - një histori e shkurtë*. Prishtinë: 1998
- Bartle, Peter. *Shqipëria nga mesjeta deri më sot*. Prizren: 1999
- Biagini, Antonella. *Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët e tona*. Tiranë: 2000
- Durham, Edith. *Brenga e Ballkanit*. Tiranë: 2000
- Durham, Edith. *The struggle for Scutary*. London: 1913
- Durham, Edith. *Twenty Years of Balkan Tangle*. London: 1920
- Hrabak, Bogumil. *Arbanski upadi i pobune na Kosovo i u Makedoniji od kraja 1912 do kraja 1915*. Vranje:1988
- Metais, Serge. *Historia e shqiptarëve nga ilirët deri te pavarësia e Kosovës*. Tiranë: 2006
- Glenny, Misha. *Histori e Ballkanit 1804-1999, Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*, Tiranë: 2007
- Jacques, Edwin. *Shqiptarët, Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Kartë e Pendë, Fondacioni Abraham Linkoln, Tiranë:1995. Titulli i origjinalit; Jackues, Edwin E. *The Albanians: An Ethnic History from Pre-Historic Times to the Present*. Copyright: 1995
- Kemal, H. Karpal. *The Politicization of Islam. Reconstructing Identity, State, Faith, and Community in the Late Ottoman State*. 2002
- Aref, Mathieu. *Shqipëria (Historia dhe Gjuha) Odiseja e pabesueshme e një populli parahelen*. Tiranë: 2007
- Shaw, J. Stanford. *Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë modern*. Tiranë:2006

b. Revistat shkencore:

- VJETARI. Arkivi i Kosovës. Prishtinë.
- Gjurmime Albanologjike. Seria e Shkencave Historike. Prishtinë.
- BULETINI. Fakulteti Filozofik. Prishtinë.
- Studime Historike. Instituti i Historisë. Tiranë dhe Prishtinë.

c. Burimet kredibile nga interneti.

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njohja me lëndën; burimet dhe literatura; vështrim i përgjithshëm mbi periudhën që e karakterizon <i>historinë moderne shqiptare 1830-1878</i>.</li> </ul>
<i>Java e dytë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fillimet e Rilindjes Kombëtare, fazat e zhvillimit të saj.</li> </ul>
<i>Java e tretë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kryengritjet e viteve 30 të shek. XIX.</li> </ul>
<i>Java e katërt:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Reformat e Tanzimatit, kryengritjet gjatë Tanzimatit.</li> </ul>
<i>Java e pestë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndryshime në jetën ekonomike dhe shoqërore të viseve shqiptare.</li> </ul>
<i>Java e gjashtë:</i>	Zhvillimi i tregtisë dhe i qyteteve, gjatë Rilindjes; gjendja ekonomike e fshatit; kurbeti.
<i>Java e shtatë:</i>	Lëvizja arsimore, kulturore e ideore në etapën e parë të Rilindjes; ideatorët e parë.
<i>Java e tetë:</i>	Planet për copëtimin e Shqipërisë; rrymat politike në Shqipëri.
<i>Java e nëntë:</i>	Kultura kombëtare në vitet 50-70 të shek. XIX.
<i>Java e dhjetë:</i>	Fillimet e Krizës së re Lindore dhe shqiptarët
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Organizimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në mbrojtjen e hapësirave shqiptare, si pasojë e luftës serbo-osmane 1877; spastrimet etnike në territoret shqiptare në sanxhakun e Nishit dhe Toplicës, 1877 nga ushtria Serbe.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Traktati i Shën Stefanit dhe tokat shqiptare.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Themelimi i Lidhjes së Prizrenit, 10 Qershor 1878; thirrja e Kuvendit të Përgjithshëm, vendimet themelore të tij.
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Lidhja e Prizrenit përballë Stambollit. Platforma e Lidhjes për krijimin e shtetit kombëtar.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Lidhja e Prizrenit dhe vendimet e Kongresit të Berlinit.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes\*:

- Hyrja me kohë në ligjërata - e domosdoshme.
- Vonesa mbi 10 minuta nuk justifikohet;
- Telefonat celularë shkyçen para se të fillojë procesi mësimor;
- Kopjimi gjatë provimit final - i ndaluar dhe ndëshkohet;
- Shfrytëzimi jo i drejtë i burimeve (plagjiati etj.) me rastin e hartimit të eseve, punimeve seminarike etj. i ndaluar dhe ndëshkohet;

Çdo kontakt me profesorin e lëndës, lidhur me çështjet që dalin nga lënda përkatëse - nëpërmjet e-mail adresave, ditëve të parapara për konsultime dhe në raste urgjente edhe përmes telefonit.

*\* Statuti i Universitetit të Prishtinës i cili është në fuqi parasheh politikat e mirësjelljes dhe misionin e Universitetit.*

*Ne do t'i përmbahemi këtij statuti, njëherësh kërkojmë që edhe studentet të jene të përkushtuar në respektimin e aktit më të lartë normativ të Universitetit të Prishtinës.*

© Bujar Dugolli, të gjitha të drejtat të rezervuara.